

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVES – kolegji i përbërë nga gjyqtarët Gani Zabeli, kryetar i kolegjit, Shqipe Qerimi dhe Afrim Shala, anëtarë, me zyrtarin ligjor. Shaban Prekalla, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.B., nga Gjilani, për shkak të veprës penale Vjedhje e rëndë, nga neni 253 par.1 nën par. 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr 880/2015, datë 05.12.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 01.03.2019, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr 880/2015, datë 05.12.2018, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan, me aktgjykimin P.nr 880/2015, datë 05.12.2018, të akuzuarin A.B., për shkak të veprës penale Vjedhje e rëndë, nga neni 253 par.1 nën par. 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së, konform dispozitës së nenit 364 par. 1 nën par. 1.3 të KPPK-së, e ka liruar nga akuza, ngase nuk është provuar se i njëjti ka kryer veprën penale të lartcekur. Pala e dëmtuar, për realizimin e kërkesës pasurore është udhëzuar në kontest civil. Shpenzimet e procedurës kanë rënë në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, aktgjykimin e ankimuar ta anulohet dhe lëndën ta kthejë në rigjykim dhe rivendosje.

Prokurori i Apelit në Prishtinë me parashtresën PPA/II.nr. 170/2019, datë 19.02.2019, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan, ashtu që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit e Kosovës mbajti seancën e kolegjit, shqyrtoj shkresat e lëndës, vlerësoj aktgjykimin e kundërshtuar në kuptim të nenit 394 të KPP, dhe pas vlerësimit të pretendimeve në ankesë gjeti se:

-Ankesa është e pabazuar.

Sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale prokurori i shtetit në ankesë pretendon se me aktgjykimin e ankimuar nuk janë të kënaqur sepse me të njëjtin janë shkelur dispozitat ligjore të Kodit të Procedurës Penale, nga se kjo shihet nga përmbajta e dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar dhe arsyetimit nga se eksiton një shpërputhje e plotë në mes tyre. Përveç këtij fakti, prokurori pretendon se si shkelje esenciale mund të konsiderohet edhe fakti se ky aktgjykim është kundërthënës edhe atë në mes asaj që është paraqitur në dispozitiv dhe arsyetimit i cili është dhënë në aktgjykim, sepse faktet dhe provat e shtjelluara e që janë paraqitur në arsyetim, janë në kundërshtim të plotë me dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar dhe kjo e bënë të njëjtin të paqëndrueshëm dhe pa bazë ligjore.

Gjykata e Apelit vlerëson se aktgjykimi i gjykatës se shkallës së parë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e të cilave u referohet në ankesë prokurori, ngase dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, në të nuk ka kundërthënie me vetveten as me arsyet e tij, është i qartë dhe konkret. Aktgjykimi i kundërshtuar përmban arsyet e duhura mbi të gjitha faktet relevante të kësaj çështje penale. Kolegji penal i kësaj gjykate, vlerëson se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje tjera esenciale të dispozitave të procedurës penale, e të cilat kjo Gjykatë sipas dispozitës së nenit 394 të KPP-së i shqyrton çdo herë detyrimisht. Po ashtu aktgjykimi i ankimuar është i përpiluar në kuptim të dispozitës së nenit 370 të KPPK-së, se gjykata e shkallës së parë ka paraqitur qartë dhe në mënyrë të plotë faktet dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara, po ashtu, në mënyrë të veçantë ka vlerësuar saktësinë e provave kundërthënëse, arsyet e mosmiratimit të propozimit konkret të palëve, si dhe arsyet në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së çështjes juridike, në rastin konkret në arsyetim veçanërisht janë shënuar arsyet të parapara me nenin 364 të KPPK-së, kur i akuzuari është liruar nga akuza. Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar ka paraqitur arsyet për çdo pikë të aktgjykimit. Andaj, kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar dispozitat e procedurës penale në këtë çështje penale kundër të akuzuarit A.B., kur të akuzuarin e ka liruar nga akuza e cila i vihet në barrë.

Prokurori e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë edhe për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike duke pretenduar se gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes së kësaj çështjeje juridike është dashur të merr parasysh deklaratën e zyrtarit policor F.M., deklaratën e të akuzuarit F.R., deklaratën e të miturit L.M., e bazuar në këto deklarata është vërtetuar fakti se të akuzuarit A. kur është shitur vetura e vjedhur në Prizren, i akuzuari F.R., i ka dhënë kinse falas sasinë e substancës narkotike në sasinë prej 50 gram, andaj, sipas ankesës, shtrohet pyetja se për çfarë arsyesh ja ka dhënë këtë sasi të drogës falas, nëse nuk e ka kryer veprën penale, vjedhjen e veturës së bashku, edhe pse i akuzuari A. është arsyetuar se nuk e ka ditur se me veturën e vjedhur kanë shkuar në Prizren dhe se mos pranimin e fajësisë i njëjti e ka bërë më qëllim për të ikur përgjegjësisë penale edhe pse ky fakt është shumë i besueshëm, mirëpo, gjykata e shkallës së parë të akuzuarin nuk e ka shpall fajtor. Prokurori i shtetit, po ashtu pretendon se, gjykata e shkallës së parë me rastin e nxjerrjes së aktgjykimit lirues në mënyrë jo të drejtë i ka vlerësuar faktet e provuara, e para se gjithash kjo është vërtetuar

nga deklarata e zyrtarit policor F.M., të akuzuarit F.R., të miturit L.M., ku me anë të deklaratave të tyre është vërtetuar fakti se i akuzuari ka kryer veprën penale të lartcekur. Nga të gjitha që u tha më lartë e sipas prokurorit dhe nga ato që gjenden në shkresat e lëndës, lidhur me këtë çështje penale, janë të dhëna të mjaftueshme që në mënyrë të qartë dëshmojnë se vendimi mbi lirimin e të akuzuarit nga akuza është i pa drejtë, i pa bazë ligjore dhe si i tillë i pa qëndrueshëm.

Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet e mësipërme të prokurorit të shtetit nuk qëndrojnë nga se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, prandaj pa të drejtë ankimohet aktgjykimi në këtë pjesë sepse gjykata e shkallës së parë drejtë i ka vlerësuar provat e administruara të propozuara në aktin akuzues dhe ato në shqyrtimin gjyqësor dhe në bazë të provave të administruara dhe fakteve të vërtetuara drejtë dhe plotësisht ka vërtetuar gjendjen faktike dhe ka gjetur se nuk është argumentuar se i akuzuari A.B. ka kryer veprën penale Vjedhje e rëndë, nga neni 253 par.1 nën par. 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së, kështu që në mungesë të provave të akuzuarin me të drejtë e ka liruar nga akuza. Sipas shkresave të lëndës. rezulton se gjykata e shkallës së parë ka administruar provat e propozuara në aktin akuzues dhe ato të propozuara gjatë shqyrtimit gjyqësor, me ç'rast ka dëgjuar dëshmitarët L.M. dhe F.M., zyrtar policor dhe, me pajtimin e palëve është lexuar edhe

deklarata e vëllait të dëmtuarit R.L.Z.L., meqenëse ai edhe pse ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt, nuk iu ka përgjigje ftesës së gjykatës, pasi që jeton jashtë Kosovës. Nga deklarata e dëshmitarit L.M., gjykata e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar se të njëjtit nuk i kujtohet data dhe muaji, por se i kujtohet se ka qenë viti 2010 ose 2011, në rastin në fjalë, ky bashkë me F.R.n, kanë shkuar në një shtëpi, ku F. e ka thyer derën dhe ka hyrë brenda në shtëpi, nga ku e ka marrë veturën “Mercedes” e cila ka qenë në garazh, ndërsa A. nuk ka qenë me të por pasi e kanë takuar rastësisht pas 3-4 orëve, u është bashkuar atyre duke hipur në veturë, për të cilën nuk e ka ditur se është e vjedhur dhe së bashku kanë udhëtuar për Prizren ku F. ia ka shitur veturën personit me emër V.A.. Nga dëshmia e dëshmitarit F.M., zyrtar policor, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se sa i përket rastit konkret ka marrë informatë se këtë vjedhje e ka kryer F.R., të cilin edhe e ka intervistuar, ndërsa lidhur me të akuzuarin A.B. nga F. dhe nga vetë A., e ka kuptuar se ai e ka shoqëruar me veturë deri në Prizren, ku pasi F. e ka shitur veturën, ia ka dhënë A. 50 gram marihuanë, ndërsa se a ka marrë pjesë A.i në vjedhje nuk ka të dhëna as nga deklarata e F. e as nga vetë A.i, i cili ka deklaruar se pasi që F. e ka vjedhur veturën rastësisht është takuar me të njëjtin dhe e ka ftuar për ta shoqëruar në Prizren. Nga leximin i deklaratës së dëshmitarit Z.L. e dhënë në Stacionin Policor në Gjilan, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se natën kritike kishte vërejtur garazha në shtëpinë e vëllait të tij R., ishte hapur dhe kur ka shkuar ka parë se mungonte vetura e tipit “Mercedes”. Bazuar në deklaratat e lart cekura, gjykata e shkallës së parë ka ardhur në përfundim se nuk ka prova të mjaftueshme të vërtetoj faktin se i akuzuari A.B. ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, ngase nga deklarata e zyrtarit policor F.M. dhe nga deklarata e dëshmitarëve F.R. dhe L.M. është vërtetuar se veprën penale e ka kryer vetë F.R. së bashku me L., fakt të cilin e kanë theksuar edhe vetë dëshmitarët ndërsa kanë theksuar se të njëjtën vepër penale nuk e kanë kryer së bashku me A.B., se i akuzuari A. as që ka ditur se vetura

ka qenë e vjedhur, por vetëm ka hipur në të, pasi që rastësisht është takuar me ta, po as nga deklarata e vëllait të dëmtuarit nuk kuptohet se kush e ka kryer veprën penale. Një vlerësim të këtillë të rrethanave si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kolegji penal i kësaj gjykate.

Gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se në rastin konkret i akuzuari nuk është përgjegjës për veprën penale për të cilën akuzohet, sepse nga faktet e ofruara nga prokurori, nuk vërtetohet se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i është vënë në barrë. Po ashtu gjykata në rastin konkret drejt ka aplikuar nenin 3 par. 2 të KPPK-së ku thuhet “se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të akuzuarit dhe të drejtave të tij”. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pas vlerësimit të provave materiale, gjykata e shkallës së parë drejtë ka konstatuara se në veprimet e të akuzuarit nuk përmbahen elementet e veprës penale për të cilën është akuzuar nga ana e prokurorit, vlerësime këto si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë.

Nga sa u tha më lartë, konform dispozitave të nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVES
PA1.nr.150/19 datë 01.03.2019

Zyrtari ligjor,
Shaban Prekalla

Kryetari i kolegjit
Gani Zabeli

Anëtarët e kolegjit:
Shqipe Qerimi
Afrim Shala